

RELACION TEKNIK

OBJEKTI

**RIKONSTRUKSIONI I RRUGES UNAZE VARREZA - PIKE TAKIMI
DHORI TANAKA**

ADRESA:

BASHKIA PATOS

1. Vendodhja

Objekti në projektujme ndodhet ne pjesen veri-lindore te qytetit te Patosit, ne lagjen Dukas Coban dhe eshte segmenti rrugor qe lidh rrugen e varrezave me rrugen Dhori Tanaka. Objekti shtrihet ne nje terren kondrinor dhe do te mundesoje lidhjen e 2 rrugeve kryesore ne kete lagje. Gjatesia e ketij segmenti eshte rreth 780 ml.



2. Përshkrimi i situatës ekzistuese

Gjendja e këtij segmenti rrugor është jo e mirë . Rikonstrukcioni i këtij segmenti zhvillohet ne nje gjatesi prej 780 m e cila kalon neper nje zone te banuar. Ky segment rrugor u sherben rreth 600 banoreve qe e perdorin per dite kete ruge per lidhjen e banesave te tyre me rruget kryesore te lagjes dhe me tej me qytetin e Patosit. Problematike ngelet infrastruktura e dobet,dhe mungesa e kanalizimeve te ujrave te zeza te lagjes duke u kthyer ne nje problem per banoret te cilet jane perfituesit direkt nga rikonstrukcioni i këtij segmenti.

3.Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë këtë segment ku do të bëhet rikonstrukcioni i plote i tij duke e pajisur me gjithë elementet e nevojshem, konkretisht:Segmenti nga piketa 0-33 me nje gjatesi totale rreth 780m e cila shtrihet ne zone te banuar do te ndertohej me elemente baze te

rruges si asfaltimi i trupit te rruges me gjeresi 3.5 m dhe bankina granili 40 cm ne te dyja anet e rruges, si edhe ndertimi I sistemit te kanalizimeve te ujrave te zeza te zones duke u afruar keshtu me standartet bashkohore, duke mundësuar në këtë mënyrë jo vetëm qarkullimin e lirshëm te automjeteve por edhe të banorëve te zonës duke minimizuar aksidentet e mundshme dhe duke përmirësuar mënyren e jetesës së tyre.

Paketa e shtresave te trupit te rruges perfshin shtrese cakelli 10 cm hedhur mbi toke natyrale te sistemuar, shtrese stabilizanti 10 cm, shtrese binderi 5 cm dhe asfaltoben me trashesi 3 cm.

Ne te gjithë gjatesine e rruges do te ndertohet sistemi kanalizimit te ujrave te zeza I cili do te jete me dy drejtimi sipas pjerresive te terrenit duke mundesuar mbledhjen e ujrave te zeza te banesave pergjate kesaj rruge dhe ndertimin e kolektorit me tubo te brinjezuar tipit S-8 me dimensione DN 400, Dn 315 dhe DN 200. Ne distanca te ndara prej 24 ml apo sipas pershtatjes me formen e rruges kemi ndertrimin e pusetave te keontollit per keto linja duke bere te mundur kontrollin e ketij kolektori por edhe lidhjen e familjeve me kete kolektor.

Teresia e ketyre nderhyrjeve do te permiresoje ndjeshem infrastrukturen e zones dhe do te sjelle nje sere lehtesirash per banoret duke mundesuar dhe levizjen e tyre me automjet por edhe me kalimin e banoreve ne kete zone.

Konceptoi :

Ing.Silvana Mici

Ing. Arben Manoku